

**STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL PËR  
KOMUNËN E GJILANIT 2024 - 2031**

## **Përmbajtja!**

**MANUALI PËR HARTIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL** Error! Bookmark not defined.

<b><u>Lista e Shkurtesave</u></b> .....	4
<b><u>Lista e Figurave</u></b> .....	5
<b><u>Lista e Tabelave</u></b> .....	6
<b><u>Grupi Punues</u></b> .....	7
<b><u>Fjalë Hyrëse nga Kryetari/ja e Komunës</u></b> .....	8
<b><u>I. Përmbledhja Ekzekutive</u></b> .....	9
<b><u>II. Hyrja</u></b> .....	10
<b><u>III. Metodologjia</u></b> .....	11
<b><u>IV. Misioni</u></b> .....	12
<b><u>V. Vizioni</u></b> .....	13
<b><u>VI. Sfondi</u></b> .....	14
<b><u>6.1 Analiza e gjendjes aktuale</u></b> .....	14
<b><u>6.2 Përkufizimi i problemit</u></b> .....	17
<b><u>6.3 Krahasimi me vendet/komunat të tjera</u></b> .....	17
<b><u>6.4 SWOT Analiza</u></b> .....	17
<b><u>6.5 Analiza e pemës së problemit (opcionale)</u></b> .....	18
<b><u>6.6 Përmbledhja e sfidave</u></b> .....	18
<b><u>VII. Objektivat</u></b> .....	19
<b><u>7.1 Objektiva e përgjithshme 1: Arsimi</u></b> .....	19
<b><u>7.2 Objektiva e përgjithshme 2: Infrastruktura</u></b> .....	21
<b><u>7.3 Objektiva e përgjithshme 3: Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale</u></b> .....	22
<b><u>7.4 Objektiva e përgjithshme 4: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural</u></b> .....	23
<b><u>7.5 Objektiva e Përgjithshme 5: Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore</u></b> .....	25
<b><u>VIII. Monitorimi dhe Raportimi</u></b> .....	26
<b><u>IX. Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor</u></b> .....	27
<b><u>X. Plani i Veprimit</u></b> .....	29

*ps: ende nuk janë përcaktuar faqet / deri ne versionin përfundimtar*

## **Lista e shkurtesave**

**SZHEL** - Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal

**PNZHE** - Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal

**SZHSEL** - Strategjia e Zhvillimit Socio Ekonomik Lokal e Komunës së Gjilanit

**PZHK** - Planin Zhvillimor Komunal

**NMV** - Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

**AKK** - Asociacioni i Komunave të Kosovës

**AZHR** - Agjencia për Zhvillim Rajonal-Lindje

**ASK** - Agjencia e Statistikave të Kosovës

**MAPL** - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

**MZHR** - Ministrisë së Zhvillimit Rajonal

**OJQ** - Organizata Joqeveritare

**MASHT** - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

**IAAP** - Institucionet e Arsimit dhe Aftësisë Profesionale

**QKMF** - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

**QMF** - Qendra e Mjekësisë Familjare

**AMF** - Ambulanca e Mjekësisë Familjare

**KRU** - Kompania Regjionale e Ujësllësit

**EF** - Ekonomitë Familjare

**QKB** - Qendra Komunale e Biznesit

**ARBK** - Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës

**MBPZHR** - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

**BE** - Bashkësia Evropiane

**KAB** - Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

**AP** - Agjencia e Punësimit

**QP & QAP** - Qendra e Punësimit & Qendra për Aftësim Profesional

**OE** - Oda Ekonomike – Dega në Gjilan

## Lista e Figurave | Grafikëve

Grafiku 1. Metodologjia

Grafiku 2. Struktura organizative e Komunës së Gjilanit

Grafiku 3. Harta e Komunës së Gjilanit

Grafiku 4. Harta Gjilani dhe Kosova 2009 - 2024

Grafiku 5. Harta e Kosovës dhe Regjioni i Gjilanit

Grafiku 6. Harta Regjioni i Gjilanit

Grafiku 7. Harta Kosova dhe korridoret 8 dhe 10

Foto 8. Autostrada R6 | “Arbër Xhaferi” | Prishtinë – Shkup

Foto 9. Liqeni Livoqit – Liqeni Akumulues – penda

Foto 10. shkolla fillore “Selami Halalqi” Gjilan

Grafiku 11. Struktura organizative Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Foto 12. Liqeni Livoqit – Liqeni Akumulues – penda

Foto 13. projekti “Ndërtimi i stacionit të Autobusëve” Gjilan

Foto 14. parku “Baja” Gjilan

Foto 15. Projekti pastrimi i shtretërve të lumenjve

## **Lista e Tabelave**

Tabela 1. Demografia e Komunës së Gjilanit

Tabela 2. Popullsia sipas viteve

Tabela 3. Numri i nxënësve viti shkollor 2022/2023

Tabela 4. Numri i nxënësve viti shkollor 2023/2024

Tabela 5. Numri i nxënësve sipas gjinisë 2023/2024

Tabela 6. Trashëgimia kulturore

Tabela 7. Buxheti 2022 – 2024

Tabela 8. Ndarja Buxhetore sipas kategorive 2022 – 2024

Tabela 9. Kufijtë Buxhetorë sipas qarkores buxhetore të vitit 2025/2027

Tabela 10. Ndikimi Buxhetor në Hartimin e Strategjisë të Zhvillimit Ekonomik Lokal

Tabela 11. Lista e projekteve të aprovuara Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB)

Tabela 12. Subvencionet - Qarkorja Buxhetore për vitet 2025/2027

Tabela 13. Skema Investimet Kapitale dhe Subvencionet 2025/2027

Tabela 12. Lista e projekteve 2025 – 2031

## Grupi Punues

Komisioni është i përbërë në tre (3) grupe:

1. Grupi i parë ka përgjegjësi direkt në Hartimin Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal duke qenë pjesë e rregullt e çdo takimi të grupit punues dhe është përgjegjëse për të dhënë propozime dhe për të draftuar strategjinë.
2. Grupi i dytë ka për obligim që ta furnizoj me të gjitha të dhënat e nevojshme grupin e parë dhe në takime të përbashkëta secili për fushën e vet ti monitoroj të dhënat dhe ti aprovojë.
3. Grupi i tretë ka karakter këshillëdhënës

Lista e anëtarëve për Hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024 – 2031

### 1. Grupi I-rë

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita dhe përshkrimi
01.	Enver Shabani	Kryesues i grupit, Drejtor për Zhvillim Ekonomik
02.	Shpresim Vranovci	Anëtar, Universiteti i UBT-së
03.	Gzim Tosuni	Anëtar, Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan
04.	Shqiprim Ahmeti	Anëtar, Universiteti i UBT-së
05.	Berat Mustafa	Anëtar, Fluidi Group
06.	Milivoje Zhivkoviq	Anëtar, Zyra për Kthim dhe Komunitete
07.	Arsim Vranovci	Anëtar, Komuniteti i Biznesit
08.	Ilirjana Uruqi	Anëtar, Kryesuese e Komitetit të DZHE
09.	Besnik Shala	Anëtar, Lëvizja Vetëvendosje
10.	Hekuran Kryeziu	Anëtar, Lëvizja Vatra
11.	Fadil Sherifi	Anëtar, AKR
12.	Erestina Isufi	Anëtar, PDK
13.	Erleta Halimi	Anëtare, Oda Ekonomike – njësia në Gjilan
14.	Fahrush Morina	Anëtar, Qendra Rajonale e Punësimit
15.	Agim Zeka	Anëtar, AZHR Lindje
16.	Valbona Tahiri	Anëtar, AZHR Lindje
17.	Nentor Shaqiri	Anëtar-Zyra e Kryetarit
18.	Besart Selimi	Anëtar-Zyra e Kryetarit
19.	Azem Mujku	Anëtar, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
20.	Fadil Osmani	Anëtar, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
21.	Arjeta Maka	Anëtar, Shoqëria Civile
22.	Muhamet Halili	Anëtar, Shoqëria Civile - Media

## 2. Grupi II-të

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita dhe përshkrimi
01.	Ali Arifi	Anëtar, Drejtor i Urbanizmit
02.	Shpend Nuhiu	Anëtar, Drejtoria e Arsimit
03.	Herolinda Murati Leka	Anëtar, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave
04.	Kushtrim Ibrahim	Anëtar, Drejtoria e Shërbimeve Publike
05.	Doruntina Hasani	Anëtar, Drejtoria e Shëndetësisë
06.	Arbenita Sopi – Haziri	Anëtar, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
07.	Kushtrim Zeqiri	Anëtar, Drejtoria e Kulturës
08.	Bekim Salihu	Anëtar, Drejtoria e Kadastrit
09.	Kujtim Bajrami	Anëtar, Departamenti i Prokurimit
10.	Entela Hyseni	Anëtar, Drejtoria e Inspeksionit
11.	Bajram Isufi	Anëtar, Drejtoria e Bujqësisë
12.	Mufail Haziri	Anëtar, Qendra për Aftësim Profesional
13.	Elhami Idrizi	Anëtar, Oda Hotelerisë – njësia në Gjilan

## 3. Grupi III-të

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita dhe përshkrimi
1.	Qefsere Bajrami	Anëtar, Ministria e Zhvillimit Rajonal
2.	Bafti Dogani	Anëtar, Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal

## FJALIA HYRËSE NGA KRYETARI I KOMUNËS



### *Të nderuar qytetarë të komunës!*

Është krenari dhe shpresë e madhe që po prezantojmë Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024 - 2031.

Ky dokument është më shumë se një plan; është një vizion për një të ardhme më të ndritur dhe më të drejtë për të gjithë ne. Ndërsa bëjmë përpara, jemi të bindur se me këtë strategji, do të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për komunën tonë, një vend ku secili prej nesh mund të realizojë potencialin e tij të plotë.

Arsimi do të jetë themeli mbi të cilin do të ngremë këtë të ardhme. Ne synojmë të ofrojmë mundësi të barabarta për të gjithë fëmijët tanë, duke siguruar që të kenë qasje në një arsim cilësor që i përgatit për sfidat e së nesërme.

Në shëndetësi, do të bëjmë çdo përpjekje për të siguruar kujdesin më të mirë të mundshëm për të gjithë qytetarët, duke investuar në pajisje moderne dhe staf të kualifikuar. Kjo është një pjesë e rëndësishme e angazhimit tonë për një komunitet të shëndetshëm dhe të lumtur.

Spektori i bujqësisë do të transformohet me inovacione të reja dhe mbështetje të vazhdueshme për fermerët tanë, duke rritur prodhimin dhe cilësinë e jetës në zonat rurale.

Ne gjithashtu do të angazhojmë diasporën tonë, duke krijuar ura lidhëse që do të sjellin investime dhe njohuri të reja në komunën tonë. Krijimi i vendeve të reja të punës është një qëllim kryesor. Duke mbështetur ndërmarrësin dhe zhvillimin e sektorit privat, ne do të krijojmë një ekonomi të fortë dhe të qëndrueshme.

Me optimizëm dhe bashkëpunim, ne mund të realizojmë këtë vizion dhe të ndërtojmë një të ardhme të ndritur për të gjithë qytetarët e komunës sonë.

Faleminderit për besimin dhe përkushtimin tuaj në këtë rrugëtim të përbashkët.

*I juaji,*  
*Alban Hyseni, Kryetar*  
*Komuna e Gjiçanit*



## I. Hyrja

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024 – 2031 është plan i strukturuar që përcakton objektivat dhe hapat për të përforcuar ekonominë lokale dhe për të krijuar kushte me të mira për të gjitha komunitet që jetojnë dhe veprojnë në Komunën e Gjilanit.

Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024 – 2031, ka mobilizuar burimet njerëzore (Zyra e Kryetarit të komunës së Gjilanit, komuniteti i biznesit, bashkëpunimin me sektorin privat, organizatat jo-qeveritare, mediat, institucionet akademike si dhe Qeverinë e Kosovës) për të ndërmarrë veprime për zhvillimin ekonomik lokal e me pasqerë të siguruar burimeve financiare për ta realizuar këtë strategji.

Kjo strategji përfshin disa hapa të rëndësishëm për të identifikuar dhe shfrytëzuar burimet dhe potencialet në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive.

Hapat që janë përfshihen e këtij dokumenti janë:

**Analiza e situatës aktuale:** Identifikimi i pikave të forta dhe të dobëta të ekonomisë lokale, si dhe identifikimi i mundësive dhe rreziqeve që ndikojnë në zhvillimin ekonomik.

**Përcaktimi i qëllimeve:** Vendosja e qëllimeve të qarta dhe të arritshme për zhvillimin ekonomik lokal, si rritja e punësimit, rritja e investimeve, etc.

**Përcaktimi i fushave me prioritet :** Identifikimi i fushave që kanë potencial për rritje dhe zhvillim, si biznese të reja inovative, arsimit, infrastruktura, shëndetësia, turizmi, teknologjia informative dhe komunikative (TIK), agrobiznesi, etj.

**Promovimi dhe marketingu:** Identifikimi dhe promovimi i avantazheve konkurruese të komunitetit në fusha të caktuara, duke përdorur marketingun e vendit dhe promovimin e prodhimeve dhe shërbimeve lokale.

**Monitorimi dhe vlerësimi i progresit:** duke ju përshtatur sipas nevojave dhe ndryshimeve në mjedisin ekonomik.

Fokusi i Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024 – 2031 është rritja potencialit të Zhvillimit Ekonomik Lokal, eliminimi i pikave të dobëta, rritja e kapitalit njerëzor për qeverisje efektive, arsim cilësor, infrastrukturë dhe mjedis të pastër, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, ambient të përshtatshëm për të bërë biznes.

## II. Metodologjia

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e Komunës së Gjilanit do të jetë dokument strategjikë ambicioz që do të përfshirë të gjitha nevojat dhe ecjet në vitet e ardhshme, duke planifikuar saktë objektiva të cilat do të ndikojnë në rritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik për të gjitha bashkësitë të cilat jetojnë dhe veprojnë në Komunën tone.

Vendimi i Kryetarit të Komunës z.Alban Hyseni i ka hapur rrugë procesit të Hartimit të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024 -2031.

Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik si bartëse e këtij procesi, bashkërisht me Grupin Punues pjesë e këtij vendimi është angazhuar në ndërtimin e një programi të qartë zhvillimor në përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit ekonomik lokal dhe në sigurimin e mbështetjes së plotë të komunitetit të biznesit.

Hartimi i strategjisë është bërë duke u bazuar në dokumentet bazike :

- Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030
- Strategjia e Zhvillimit Socio Ekonomik Lokal e Komunës së Gjilanit 2017 – 2021
- Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) i cili është në fazën e aprovimit

Grupi Punës pjesë e se cilës janë akterët nga Drejtorit Komunale, Universiteti Publike “Kadri Zeka” dhe Universiteti UBT, Komuniteti të Biznesit, Anëtarët nga Partitë Politike, , Agjensioni për Zhvillim Rajonal – LINDJE, Institucionet si Qendra e Punësimit, Oda Ekonomikë – Dega në Gjilan, Qendra për Aftësim Profesional, Shoqëria Civile, OSCE – Njësia në Gjilan, Konsulentë dhe Ekspertë të Jashtëm, Mediat si dhe Qeveria e Kosovës (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal)


Kontributet e marra gjatë takimeve të mbajtura, komentet dhe sugjerimet e marra nga palët e interesit | komuniteti i biznesit | gjatë hartimit të strategjisë ishin mjaft të rëndësishme për ta kompletuar dhe finalizuar këtë dokument.

Më pastaj është përcaktuar misioni dhe vizioni i komunës si dhe janë përcaktuar objektivat, aktivitetet dhe qëllimet, po ashtu është bërë një plan veprimi për të monitoruar dhe vlerësuar strategjinë.

Qëllim parësor i kësaj strategjie është modelimi i kapacitetit ekonomik të Komunës së Gjilanit, për të përmirësuar të ardhmen e saj ekonomike në krijimin e kushteve me të mira për të gjitha komunitet të cilat jetojnë dhe veprojnë në Komunën e Gjilanit.

Përmes Strategjisë Zhvillim Ekonomik do të bëjmë te mundur të përcaktojmë politikat e zhvillimit ekonomik lokal dhe të sigurojmë zbatimin e tyre, prandaj gjate gjithë kohës ishte shumë e rëndësishme të marrim parasysh mendimet dhe konsultimet për çdo çështje që shqetëson qytetin tonë.

### Grafiku : Metodologjia




Strategjisë Zhvillim Ekonomik do të ofroj hapësira të mira jetese për brezat e ardhshëm, ne kemi hedhur një hap drejt qëllimit për t'u bërë komuna jone një vend i sigurt për te jetuar dhe pe te punuar.

### III. Misioni

Misioni për komunën e Gjilanit në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal është që të krijojë një mjedis të favorshëm për zhvillimin ekonomik dhe rritjen e qëndrueshme.

Misioni ynë fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës, promovimin e investimeve dhe rritjen e aftësive të fuqisë punëtore, me qëllim zhvillimin e sektorëve kyç të ekonomisë lokale. Ne angazhohemi të tërheqim investime të reja, të mbështesim bizneset ekzistuese dhe ato në krijim, si dhe të përmirësojmë cilësinë e jetës për qytetarët e Gjilanit.

Kështu, ne synojmë të krijojmë një ambient të favorshëm për zhvillim ekonomik dhe mirëqenie sociale duke balancuar dhe shfrytëzuar resurset lokale që promovojnë inovacionin dhe sipërmarrjen dhe të sigurojë një mjedis të mirë për jetesë dhe punë për të gjithë banorët e saj.



#### IV. Vizioni / Komuna e Gjilanit



"Gjilani, një qendër ekonomike, kulturore dhe inovative, ku buzëqeshja dhe prosperiteti lulëzojnë për të gjithë banorët dhe regjionin e Anamoravës, duke respektuar dhe kultivuar vlerat e gjeneratave të kaluara."

## V. Sfondi

Sfondi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024 - 2031 është një pjesë e rëndësishme e procesit të hartimit të strategjisë, sepse ofron kontekstin dhe bazën analitike për të formësuar qëllimet dhe masat e strategjisë në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive.

Ky kapitull siguron bazën e nevojshme për të kuptuar kontekstin dhe sfidat përpara dhe është udhëzues për përcaktimin e objektivave dhe masave konkrete të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal.

Pasqyrimi i detajuar dhe i plotë i këtyre elementëve siguron që strategjia të jetë e përputhur dhe e qëndrueshme në kontekstin e komunës së Gjilanit .

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024 -2031 është pjesë integrale e Programit Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e Komunës së Gjilanit do të jetë një udhërrëfyes për vitet e ardhshme duke planifikuar objektiva të cilat do të ndikojnë në rritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi.

Objektivat kryesorë të Komunës së Gjilanit lidhen kryesisht me zhvillimin ekonomik, bazuar në udhërrëfyesin nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal si indikator kryesor janë marrë :

- ✓ Sektori i Arsimit: cilësia, avancimi dhe përmirësimi
- ✓ Sektori i Infrastrukturës: kushtet e jetesës, rrugë, ujëra të zeza, ndriçim
- ✓ Sektori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale: ruajtja e shëndetit
- ✓ Sektori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: mbjellje, ferma, pemishte ruajtja e mjedisit
- ✓ Sektori i Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore: turizmi dhe rekreacioni

Sfondi jep hapësirë që të gjitha analizat e bëra përshkruhen në detaje për të ofruar një kuptim të plotë të situatës ekonomike dhe kontekstit në të cilin do të realizohet Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024 -2031 .

## **6.1 Analiza e gjendjes aktuale**

Për këto vite pas luftës janë bere përpjekje maksimale që ta zhvillojmë infrastrukturën dhe bazën ekonomike të Komunës së Gjilanit.

Sot, janë shënuar përpjekje të dukshme në ndërtimin e rrjetit të rrugëve, si në zonën urbane, ashtu edhe nëpër fshatra. Janë ndërtuar dhjetëra kilometra ujësjellës e kanalizime në tërë hapësirën e komunës si dhe është punuar shpejt dhe mirë në zgjerimin e hapësirës shkollore dhe pajisjen e shkollave me inventar të ri.

Është punuar mirë në ndërtimin e zonave të gjelbra, vetëm gjate vitit qe 2023 mes dy lagjeve me te mëdha te qytetit asaj Dardania dhe Dheu i Bardh është rregulluar “Parku Baja” investim kapital i cili po ofron freskinë, sport e aktivitete rekreative për qytetaret e komunës sonë, po ashtu është punuar ne rregullimin e parkingjeve e trotuareve, ndriçimit publik, fusha sportit, objekteve shkollore kudo në komunë.

Ambiciet e tona janë që të ndërtojmë parakushte të mira për ardhje të investimeve në komunën e Gjilanit dhe për zhvillim sa më të shpejtë ekonomik të saj. Niveli i politikës lokale ne koordinim me Qeverinë e Kosovës ku ekziston një marrëveshje e përgjithshme sa i përket Zhvillimit Ekonomik të Kosovës që investimet private dhe investimet e huaja në veçanti duhet të jenë një nga shtytësit kryesorë të rritjes ekonomike të vendit.

Kryetari i komunës se Gjilanit z. Alban Hyseni dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik i kanë hapur rruge këtij procesi | krijimi i një mjedisi tërheqës për investime | Zhvillimi i Zonës Ekonomike është një nga instrumentet kryesore për të mbështetur investimet private në Kosovë.

Përgatitja e studimit të fizibilitetit para zhvillimit të zonës nuk është vetëm një praktikë më e mirë ndërkombëtare e njohur, por edhe një kërkesë ligjore bazuar në Ligjin Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike | Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Vetë ligji parashikon që një studim fizibiliteti duhet të përgatitet para se të krijohet ndonjë zonë ekonomike, komuna e Gjilanit po ecën mire në këtë proces, sipërfaqja e ndarë e Zonës Ekonomike prej 146.5 hektarë është lehtësisht e akseseshme nga se aseti kryesor | Toka është në pronësi komunale dhe komuna e Gjilanit si pronare do ta ketë më të lehtë zhvillimin e kësaj zone ekonomike, pa kosto për shpronësim, kjo e bene edhe me atraktive.

## 6.2 Struktura dhe funksionimi i Komunës së Gjilanit

Në bazë të neni 12.2 dhe 12.3 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 4 qershor 2008), Kuvendi i Komunës në Gjilan në mbledhjen e mbajtur më datën 21.11.2008, në përputhje me këtë ligje miraton: Statutin e par të Komunës së Gjilanit ku thuhet :

- ✓ Komuna e Gjilanit është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e cila ushtron tërë pushtetin, i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore.

Në vitet ne vijim ka pas ndryshime e plotësime te këtij statuti se pari ne vitin 2014 e me pas në mbështetje të vendimit 01. nr. 016-6870 të datës 19.01.2018, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me datën 22.03.2018, miraton : Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të Komunës së Gjilanit.

Statuti është akti më i lartë juridik i Komunës, i cili e rregullon organizimin e brendshëm të Komunës së Gjilanit po e përshkruajmë funksionimin e Komunës së Gjilanit.

### Organet e komunës janë:

1. Kuvendi i Komunës është organ më i lartë i Komunës dhe

---

2. Kryetari i Komunës është organi më i lartë ekzekutiv i komunës.

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë, i cili zgjidhet në mënyrë të Drejtpërdrejtë nga qytetarët (ne mandate 4 vjeçar) në pajtim me ligjin për zgjedhjet lokale, Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka 35 anëtarë.

Kryetari i Komunës zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejt nga njerëzit që kanë të drejtë vote në komunë, në përputhje me Ligjin mbi zgjedhjet komunale në fuqi. Kryetari i Komunës zgjidhet për mandat (katër vjeçar) sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës në pajtim me ligjin.




Në bazë të nenit 62.1 të LVL, administrata komunale Organizohet në Drejtori ku përfshijnë:

- 1.1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme,
- 1.2. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,
- 1.3. Drejtoria e Arsimit,
- 1.4. Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- 1.5. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- 1.6. Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim,
- 1.7. Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë,
- 1.8. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
- 1.9. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
- 1.10. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
- 1.11. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
- 1.12. Drejtoria e Inspeksionit.

Çdo drejtori komunale ka drejtorin që emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i komunës, në pajtim me nenin 62.2 të LVL. Drejtorët menaxhojnë dhe udhëheqin drejtorinë e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të kryetarit të komunës dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi.

Përpos drejtorive komunale, Kuvendi i Komunës themelon edhe këto zyre, njësi si në vijim: Kabineti i Kryetarit, Njësia e Kuvendit, Njësia për Personel, Njësia për të Drejtat e Njeriut, Njësia e Auditimit të Brendshëm, Zyra Ligjore, Zyra e Avokatit të Komunës, Zyra e Informimit, Zyra për Integritet Evropian, Zyra e Prokurimit, Zyra për Komunitete dhe kthim dhe Zyra për Preshevë, Mendvegje dhe Bujanovc

## Struktura organizative e Komunës së Gjilanit



Kjo skemë organizative Komunën e Gjilanit e bën të fortë dhe efikase në punën e tyre, kjo skemë e dalën nga zemra e statutit të komunës është dizajnuar që të ndihmojë stafin ekzekutiv, drejtorët dhe menaxherët që përfaqësojnë sektorët specifik.

Tani më llogaridhënia është shumë transparente duke i përfshirë qytetarët në mënyrë pro aktive në procesin vendimmarrës.

Sot, kemi siguruar besimin e publikut në institucione, kemi minimizuar shkallën e gabimit në vendosjen e prioriteteve dhe ofrojmë bazë të mirë për plotësimin e nevojave të qytetareve për të gjitha komunitetit.

## Fshatrat vendbanime sipas zonave kadastrale

Territori dhe kufijtë e komunës janë të përcaktuar në Ligjin për kufijtë administrativ të komunave, si në vijim:

- |                        |                   |
|------------------------|-------------------|
| 1. Bilinicë            | 22. Kmetoc        |
| 2. Bresalc             | 23. Kravaricë     |
| 3. Bukovik-Caparë      | 24. Lipovicë      |
| 4. Burincë             | 25. Llovcë        |
| 5. Velekincë           | 26. Goden i Vogël |
| 6. Lladovë             | 27. Malishevë     |
| 7. Llashticë           | 28. Muçibabë      |
| 8. Vrapçiq             | 29. Nasalë        |
| 9. Verbicë             | 30. Pidiq         |
| 10. Gadish             | 31. Pogragjë      |
| 11. Gjilan             | 32. Ponesh        |
| 12. Sllakovc i Epërm   | 33. Përlepticë    |
| 13. Livoq i Epërm      | 34. Sllubicë      |
| 14. Sllakovc i Ultë    | 35. Stançiq       |
| 15. Livoq i Ultë       | 36. Stublinë      |
| 16. Dunav              | 37. Uglarë        |
| 17. Zhegoc             | 38. Cërmicë       |
| 18. Verbicë e Zhegocit | 39. Çelik         |
| 19. Zhegër             | 40. Shillovë      |
| 20. Inatoc             | 41. Shurdhan      |
| 21. Kishnapolë         | 42. Dobërqan      |

Vitet 1980/1990 janë vitet e fundit ku në Kosovë por edhe në Ballkan popullsia do të ishte më përqendruar më shumë në zonat rurale se ato urbane.

E sidomos pas luftës në Kosovë, të gjithë shqiptarët do të rendin nga fshati drejt qyteteve duke “braktisur” tërësisht fshatrat / me gjithat “braktisjen” sakët do ta përcaktoj regjistrimi i fundit i popullsisë.

## Demografia e Komunës së Gjilanit

Gjilani është qendër e mirëfilltë e regjionit të Anamoravës, popullsia e Komunës së Gjilanit, përherë ka qenë e përzier, me dominimin e shqiptarëve gjate te gjitha sundimeve | jetojnë këto komunitete: Shqiptarë, Serbë, Turq, Romë dhe të tjerë.

### Vitet 1980 – 1990

Vitet	1981	1991
Meshkuj	43 294	53 360
Femra	40 791	50 315
<b>Gjithsejtë (Bruto)</b>	<b>84 085</b>	<b>103 675</b>
Qyteti	35 229	51 912

### Viti 2002

Sipas publikimit të Entit të Statistikave të Kosovës, dhjetor 2002, numri i përgjithshëm i banorëve ishte 133.724 (68.814 meshkuj dhe 64.910 femra).

Vlerësohet se në vitin 2002, numri i banorëve në 1 km<sup>2</sup> ka qenë 254, ose një rritje prej 55.83% në krahasim me vitin 1981, kur numri i banorëve në 1 km<sup>2</sup> ishte 163. Norma vjetore neto e rritjes së popullatës është vlerësuar të jetë rreth 2.3%.

### Viti 2011 - sipas regjistrimit prill 2011

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është prodhuesja kryesore e statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës, përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave, si dhe koordinatore e Sistemit Statistikor të Kosovës.

Komuna e Gjilanit në bazë të regjistrimit të fundit të bërë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka këtë strukturë të popullsisë

Banesat	Ekonomit familjare	Gjithsejtë	Meshkuj	Femra
23,186	17,048	90,178	45,354	44 824
Të dhënat tjera				
Gjithsejtë numri i banoreve		Qyteti	Zonat rurale	
90,178		54,239	35,939	

Komuna e Gjilanit ka një moshë të re ku rreth 37% përbëhet nga moshë 0-19, po ashtu vlen te ceket se rreth 27.5% e përbëjnë moshën nga 15-29 vjeç që konsiderohet një potencial i mirë.

Bazuar në web faqen | <https://ask.rks-gov.net> | e tyre sot, kemi këto te dhëna të treguesve kryesor :

Te dhënat sipas kategorive				
Popullsia viti 2011	Paga € viti 2022	Papunësia % 2023   TM2	BPV 2023   TM4	Inflacioni % 2024   M03
1739,835	521	10.7	3,96	2.3

Sipas te dhënave nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme gjatë viti 2023 kemi këto te dhëna :

- Lindje : 1881 - foshnje
- Martesa : 1014
- Shkurorëzime : 67
- Vdekje : 593 - persona

Diferenca mes raportit Lindje / Vdekje është 1,288, kjo është pozitive por jo e kënaqshme, ne po japim te dhëna edhe për këto vite mes lindjeve dhe vdekjeve :

### Lindjet

Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
<b>Foshnjat e lindura</b>	1589	1530	1207	1378	1224	1052	1110	1108

### Vdekjet

Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
<b>Personat e vdekur</b>	488	501	417	397	453	498	470	512

## Vitit 2024 - sipas regjistrimit të fundit prill 2024

Kosova nisi regjistrimin e popullsisë më 5 prill 2024, zyrtarisht me date 25 maj 2024 ka përfunduar procesi i regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave | Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ende nuk e ka bere publikimin e te dhënave te fundit |

Korrik 2024 | Bazuar në web faqen | <https://ask.rks-gov.net> | të dhënat e publikuara

- n'Kosovë jetojnë : 1,586,659 banorë

---

- Femra : 791,614 – 49.9%

---

- Meshkuj : 795,045 – 50.1%

Qytetaret e komunave veriore të Kosovës e kanë bojkotuar regjistrimin e popullsisë, po ashtu në këtë numër nuk përfshihet Diaspora.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), sipas rezultatit preliminar te publikuar | Komuna e Gjilanit ka 82,901 banorë

Mosha mesatare është rritur, deri sa ne vitin 2011, mosha mesatare ne vend llogaritet të jetë rreth 30 vjeç | tani është 34.32 vjet


Sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (sipas rezultatit preliminar te publikuar) Gjilani dhe rajonet përreth grumbullojnë gjithsej 150 mijë e 050 banorë.

- Komuna e Gjilanit ka regjistruar 82 mijë e 901 banorë
- Komuna e Parteshi me 3251 banorë,
- Komuna e Ranilluku me 2402 banorë
- Komuna e Klllokoti ka regjistruar 3049 banorë.
- Komuna e Vitisë regjistron gjithsej 35 mijë e 549 banorë,
- Komuna e Kamenicës ka 22 mijë e 898 banorë.

Komuna e Novobërdës, sipas regjistrimit të 2011-tës, ka pas 6729 banor, fatkeqësisht procesi nuk ka shkuar siç duhet, sepse komuniteti serb ka filluar ta bojkotojë këtë proces të regjistrimit të popullsisë / s'kemi numër te saktë!

## Shtrirja gjeografike

Komuna e Gjilanit gjendet në pjesën juglindore të Kosovës, rajoni i Anamoravës, me një sipërfaqe prej 515 km<sup>2</sup>, deri në vitin 2010 kur me procesin e decentralizimit i merren 123 km<sup>2</sup>, Komuna e Gjilanit tani ka 392 km<sup>2</sup>



Map 1 | Gjilani dhe Kosova viti 2009-2020

Komunat e Regjionit Lindje:

- Gjilan
- Viti
- Novobërdë
- Kamenicë

Komunat e krijuara me procesin e decentralizimit:

- Klllokot,
- Partesh dhe
- Ranillug


Bashkëpunimi Ndërkufitar pjesë integrale e Regjionit Lindje :

- Komuna e Preshevë dhe
- Komuna e Bujanocit
- ✓ Komuna e Likovës dhe
- ✓ Komuna e Kumanovës

Gjilani daton nga viti 1772 dhe është themeluar nga familja e Gjinajve, e cila që nga viti 1737 ka sunduar një pjesë të Kosovës. Sulltani ka njohur pushtetin e kësaj familje.

Gjinajt erdhën në Gjilan nga qyteti mesjetar i Artanës (Novobërdë), si themelues njihet Bahti Beg Gjinolli.

Gjilani është qendër e mirëfilltë e regjionit të Anamoravës, e cila bashkë me komunat pranë saj, Vitinë, Klllokotin, Parteshin, Novo Brdën, Kamenicën e Ranillukun, por edhe me Preshevën dhe Bujanocin (Kosova Lindore) e tani më afër edhe me Likovën dhe Kumanovën (Maqedonin e Veriut) përbejnë një komunitet prej rreth gjysmë milioni banorësh.



Atraktive këtë region e bënë Lumi Morava e Binçës buron në Malet e Karadikut në territorin e Maqedonisë në jug të Vitisë e në veri të Shkupit. Dy rrjedha formojnë Përroin e Madh, i cili kur të kalon kufirin njihet si Morava e Binçes | emrin e ka marr nga vendbanimi Binçë.

Lumi Morava e Binçës rrjedh nëpër fushën e Anamoravës nëpër Lladovë, Velekincë, Pisjan, Uglar, Pogragjë e deri te Dobërçani (Mireshti), e deri në ngushticën e Konçulit kalon në Luginën e Preshevës ku pas 49 km gjatësi i bashkohet Morava e Vogël e Preshevës në afërsi të Bujanocit.

Morava e Binçës i takon pellgut të Detit të Zi. Bashkohet me Moravën Perëndimore të cilat bashkohen dhe derdhen në Danub e pastaj në Detin e Zi.

Komuna e Gjilanit është njëra nga komunat qe me se shumti është prek nga procesi i decentralizmit ne vitin 2010.



Nga viti 2010, Komuna e Gjilanit kufizohet : në juglindje me Preshevën (33km) dhe Kumanovën (malet e Karadakut), në lindje me Bujanovcin (40.5km), në verilindje Kamenicën (29km), në jug ka Vitinë (20km), në perëndim Lipjanin dhe Prishtinën (47km) në verilindje me Novobërdën,(19.5km)



Map 3 | Sot, Regjioni i Gjilanit!

Sot, Komuna e Gjilanit kufizohet : në juglindje Pasjanin e me Preshevën dhe Kumanovën (Likovën) | malet e Karadakut, në lindje me Ranillukun e Bujanovcin e në verilindje Kamenicën e me Novobërdën, në jug ka Parteshin e Vitinë në perëndim Lipjanin dhe Ferizajn.

Pozita gjeografike e Gjilanit mundëson lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit, duke qenë edhe një qendër e rëndësishme në trekëndëshin Gjilan-Preshevë-Kumanovë.

• Lidhja e Komunës së Gjilanit me territorin e Serbisë bëhet përmes :

- Rrugës magjistrale Gjilan – Bujanoc - Vranjë nëpër grykën e Konqulit | lidhja me autostradën Beograd – Shkup
- Lidhja tjetër e komunës sonë me Serbinë bëhet përmes rrugës regionale Gjilan-Pasjan – Muçibab – Preshevë dhe del në magjistralen Preshevë – Shkup .

• Lidhja e Komunës së Gjilanit me territorin e Maqedonisë së Veriut bëhet përmes :

- Lidhja tjetër e komunës sonë me Maqedoninë e Veriut (Likovën dhe Kumanovën) bëhet përmes rrugës regionale Gjilan- Zhegër – Stançiq – Kumanovë dhe del në magjistralen Beograd – Athinë | korridori 8 dhe 10



Map 4 | Kosova dhe Korridoret Paneuropiane 8 dhe 10

Tani po punohet me te madhe | **Autostrada R 7.1 / A3** është një autostradë e gjatë 45.9 kilometra në Kosovë që është në ndërtim e sipër | kjo krijon lidhje me kryeqytetin e Kosovës (Prishtinën) nëpërmjet Gjilanit me pikën kufitare Dheu i Bardhë në kufi me

Serbinë | si do qoftë, kjo autostradë ka një gjatësi totale prej 47.1 kilometra dhe do të lidhë do të lidhë korridorin 6, 7 dhe 10 | pjesë e në rrjetit TEN-T (Rrjeti Trans-Evropian i Transportit) | infrastruktura e Ballkanit Perëndimor që është pjesë integrale e korridoreve evropiane | që është me rëndësi strategjike.

Këto korridore krijojnë qarkullim të lehtë dhe i shpejtë i njerëzve dhe mallrave në masë të madhe do ta bëjë ndryshimin e ritmit të zhvillimit ekonomik, shoqëror e të gjithmbarshëm të vendeve tona.

Rrugët magjistrale dhe autostradat te rëndësisë se veçantë ne qarkullimin e lire te mallrave dhe njerëzve qe lidhin Komunën e Gjilanit me qendrat tjera dhe shtet tjera e ato janë :

Nr.	Emërtimi i rrugëve	Gjatësia
01.	Rruga Gjilan – Muqibabë – Preshevë (Serbi) dalja ne korridorin 10	33 km
02.	Autostrada Gjilan - Kamenicë – Bujanovc (Serbi) dalja ne korridorin 10	40.5 km
03.	Rruga Gjilan- Zhegër – Stançiq – Kumanovë (Maqedoni) dalja ne korridorin 8	35 km
04.	Rruga Gjilan – Partesh – Viti – Ferizaj dalja ne autostradën R6 korridorin 8 e 10	32 km
05.	Rruga Gjilan - Prishtinë – Aeroport dalja ne autostradën R7 korridorin 8	60 km
06.	Rruga Gjilan - Novobërdën	19.5 km



**R 6 Motorway | Prishtinë - Shkup (North Macedonia)**

Foto 4 | Autostrada R6 “Arbër Xhaferi” dhe lidhja me Korridoret Paneuropiane 8 dhe 10

## Hekurudha

Komuna e Gjilanit nuk ka hekurudhë, stacioni më i afërt i trenave është në Ferizaj 33 km larg, kjo nuk e pengon zhvillimin e komunës nga se rruga magjistrale Gjilan – Ferizaj ofron kushte të mira të transportimit të mallrave .

## Aeroporti

Aeroporti më i afërt është në Prishtinë rreth 60 km larg nga Gjilani nëse shfrytëzohet magjistranja Gjilan – Prishtinë – Aeroport dhe rreth 50 km nëse shfrytëzohet magjistranja Gjilan – Lipjan – Aeroport , po ashtu ka edhe aeroportin e Shkupit 86 km.

Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari” Prishtinë

---

Aeroporti Ndërkombëtar i Shkupit | Maqedonia e Veriut

Aeroportet kanë lidhje dhe linja të mirat me të gjitha shtet si ato në perëndim dhe në lindje, po ashtu aeroporti ndërkombëtare ofron shërbime për pasagjerë dhe shërbime #Cargo”

## Rrugët ujore të lundrueshme

Rrugët ujore është Deti Adriatik gjegjësisht porti i Durrësit (320 km) dhe i Shëngjinit (290 km) të cilat ofrojnë shërbime të mira nga se janë porte me ujë të thellë për bartësit e ngarkesave, po ashtu Komuna e Gjilanit është pjesë integrale e rrugës së kombit R7 Autostrada Prishtinë – Tiran – Durrës

Karakteristikat e komunës së Gjilanit në Kosovë

- koordinatat gjeografike : 42°27'53"N 21°28'1"E

---

- zona kohore : UTC+1 (CET)

---

- zona kohore verës (DST) : UTC+2 (CEST)

---

- kodi postar : 60000

---

- prefiksi : +383 (0) 280

---

- numri targave të automjeteve : 06

---

- web faqja : [kk.rks-gov.net/gjilan/](http://kk.rks-gov.net/gjilan/)

## Ujërat termo-minerale

Rrethina e Gjilanit është e pasur me xehe (hekur e leucid) dhe me burime minerale (Nasalë, Pidiq, Kmetoc, Uglarë, Përlepnice).

Banja e Uglarit afër fshatit Uglar, 9 km në juglindje të Gjilanit, uji i këtyre burimeve akumulohet në pishinë natyrale të gjatë 8 e të gjerë 3-4 metra, si dhe të thellë 50-60 cm. Temperatura e ujit është 29°C dhe popullsia e përdorë për shërimin e shumë sëmundjeve.

Baja e Dobërçanit, i ku burojnë disa gurra me ujë mineral, është i njohur si ujë i thartë i Doberqanit, i cili përdoret për pije dhe për shërimin e shumë sëmundjeve të ndryshme. Sasia e ujit është një litër për sekondë, kurse temperatura e ujit 27 °C

Koordinatat e shtrirjes së qytetit të Gjilanit janë 42 shkallë në veri dhe 21.20 shkallë në lindje dhe në një lartësi mbidetare qyteti prej 501 dhe 590 m ndërsa regjioni prej 475 m në Budrikë deri në 1000 m lartësi mbidetare në zonën kufitare me Maqedoninë (Stançiq).

Në hartat sizmike, Gjilani njihet si rajon me shkallë të lartë rrezikshmërie. Në vitin 2002, Gjilani është goditur nga një tërmet, i cili ka lënë një të vdekur, dhjetëra të lënduar dhe mbi 8 mijë objekte publike dhe private të dëmtuara.

## Klima :

Në regjionin e Gjilanit mbretëron klima e mesme kontinentale, ngase ka një lartësi relative mbidetare prej 410 m. Nuk ka erëra të forta në Fushën e Gjilanit. Rëndom frynë veriu i cili vjen nga verilindja. Kjo erë është e thatë, e ndonjëherë kur vjen me të shiu është i imët dhe i shkurtër. Kjo erë është e ftohtë, gjatë dimrit shpesh sjell borë të imtë.

Mesatarja e temperaturave vjetore për Gjilan është 10.6 °C, temperatura mesatare e muajit më të ftohtë është ajo e janarit -0,9 °C , e muajit më të ngrohtë e korrikut me 20,7 °C

## Liqenet artificiale

Komuna e Gjilanit ka dy liqenin e artificiale :

Liqeni Akumulues i Përlepnices

Liqeni Akumulues i i Livoçit

**Liqeni Akumulues i Përlepnices** është ngritur në vitin 1966 shfrytëzohet edhe për pije edhe për ujitje të 350 hektarëve tokë të punuar. Liqeni akumulues i Përlepnices është formuar në lumin me të njëjtin emër. Vëllimi i ujit të tij është 4.2 milionë m<sup>3</sup>. Ka një sipërfaqe prej 1.634 km<sup>2</sup>, dhe prurje prej 16.32 m<sup>3</sup> ujë në sekond.

**Liçeni akumulues i Livoçit**, gjendet në lumin e Livoçit dhe është në afërsi të Gjilanit, është qendër e rëndësishme rekreative e banorëve të qytetit dhe e popullsisë përreth. Prapa pendës së betontë, e cila është e lartë 21 metra, është formuar një akumulacion prej 1,6 milion m<sup>3</sup> ujë.



*Foto : Liçeni akumulues i Livoçit*

Organizata Promoting Private Sector Employment | PPSE & Swiss Contact), ka punuar Master planin dhe studimin e Fizibilitetit për zone turistike në liçenin e Livoçit.


E ndarë zona të veçanta në përputhje me mjedisë të ndryshme | Një zonë natyrore ku se pari do te rregullohen pjesa e kënetave (moçalit) e me pas zhvillimi të një shtegu edukativ prej drurit për këmbësorë | Një zonë për ngasje të lirë me zhvillimin e teleferikut për rrëshqitje me ski në ujë (ang. waterski) dhe dërrasave për rrëshqitje në ujë (ang. wakebord) | Një zonë familjare: me zhvillimin e plazheve, këndit të lojërave të volejbollit, ngjitjeve, por edhe lundrimin me kajak dhe zonës për marrje me qira të biçikletave malore.

## Administrata

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Ligji Nr. 03/L-040, Komuna është përgjegjëse kryesisht për ofrimin dhe kryerjen e shërbimeve primare ndaj qytetarëve. Si rezultat, Komuna e Gjilanit ofron shërbimet dhe merr përgjegjësitë e përcaktuara nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale Ligji Nr. 03/L-040 dhe Ligjet tjera specifike.

Administrata Komunale sot është shumë funksionale dhe efikase në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe profesionale për qytetarët e Komunës së Gjilanit.

### Struktura organizative Drejtoria e Administratës



Komuna e Gjilanit ka arritur t'i realizoj synimet dhe objektivat e parapara sipas ligjeve aplikative në fuqi. Janë shumë rezultate dhe angazhime në administratën komunale, që për qëllim kanë krijimin e kushteve më të mira për qytetarët e komunës tonë.

## Qendra për Shërbim me Qytetar

Luan një roj mjaftë të rëndësishëm për arsye se kontakti i parë i qytetarit me komunën arrihet përmes kësaj zyre, në këtë zyre qytetarët drejtohen dhe marrin informacion të saktë për secilën zyre dhe çdo shërbim i behet në mënyrë korrekte.

Numri i Qytetarëve që kanë marrë shërbime në Qendrën për Shërbim me Qytetar gjatë vitit 2023:

- Kërkesa nga Qytetarët : 27,743
- Kërkesa nga Bizneset : 591
- Gjithsejtë janë 28334

### Sektori i Gjendja Civile :

Përbëhet nga zyrtarët e gjendjes civile të cilët kryejnë veprime të shërbimit të gjendjes civile siç janë : plotësimi, përditësimi dhe administrimi i regjistrave të gjendjes civile, zhvillimi i procedurave administrative, mbajtja e akteve të gjendjes civile, lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile si dhe veprimeve tjera juridike administrative në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Numri i qytetarëve që kanë marrë shërbime në Gjendjen Civile gjatë vitit 2023

<b>Certifikata e lindjes:</b>	<b>Ekstrakt i Lindjes:</b>	<b>Certifikata e Shtetësisë:</b>	<b>Certifikata e martesës:</b>	<b>Certifikata e vdekjes:</b>
24 916	48 397	892	13 546	11 535
<b>Certifikata e vendbanimit:</b>	<b>Certifikata e gjendjes martesore:</b>	<b>Deklarata e bashkësisë familjare:</b>	<b>Vërtetim nga arkiva:</b>	
2 847	2 714	12 888	3 306	

Drejtorja e Administratës gjatë vitit 2023 ka kryer në total 116 234 shërbime për qytetar!



## **Autoparku**

Autoparku i veturave tani me është bërë vendosja e GPS-ve në automjetet zyrtare | funksionimi i veturave zyrtare është ne përputhje me te gjitha rregullat e përdorimit te veturave zyrtare, po ashtu edhe shpenzimet e derivateve dhe mirëmbajtja e tyre

## **Numri i stafit aktual ne Administratën Komunale**

---

294 – numri i te punësuarve

---

26 – numri i te punësuarve nga komunitete jo shumicë

---

11 – numri i femrave nga komunitete jo shumicë

---

1 – numri i punëtoreve me nevoja te veçanta

---

Gjendja momentale : Objekti i Administratës së Komunës është ne fazën e renovimit, projekt i cili po bashkë financohet edhe nga Zyra e Bashkimi Evropian, po krijohen kusht për qasje të lehtë të sigurt, për shërbime të shpejta e cilësore edhe për Personat me Aftësi të Kufizuar, ku përmes vendosjes se ashensorit pastaj rregullim të nyejve sanitare ne përputhje me standardet e kërkuara.

Aktualisht : 70 praktikantë janë angazhuar në kuadër të programit K-GenU, në kohëzgjatje prej 3 muajve me pagesë. Ky projekt mundëson praktikë profesionale për të rinj, si tranzicion nga shkolla në punë.

## **Administrata | Gjilani | Kosova**

Të angazhuarit në Administratë, ndihmojnë duke asistuar në shërbimet e platformës elektronike shtetërore e-Kosova, sa herë që ka kërkesa nga qytetarët për këto shërbime.

## Arsimi

Prioritet i komunës së Gjilanit është që të punohet në ngritjen e cilësisë në arsim, po ashtu prioritet do të jenë shkollat profesionale, duke i përshtatur profilet me nevojat e tregut të punës.

Arsimi para fillor, fillor dhe i mesëm është një nga segmentet kyçe, ka pasur një rritje në investime për të siguruar që të gjitha shkollat e nivelit fillor dhe të mesëm kanë infrastrukturën dhe resurset e nevojshme për të ofruar një arsim cilësor.

Po ashtu edhe sa i përket shtrirjes së arsimit fillor dhe të mesëm ofrojnë arsim në gjuhën shqipe, serbe, turke dhe romë pra gjithëherë i kemi pasur parasysh komunitetet e ndryshme etnike të cilat jetojnë dhe veprojnë në komunë.

Në nivelin, parashkollor, fillor dhe të mesëm, ka një varietet institucionesh arsimore, duke përfshirë shkolla të ndryshme të mesme publike dhe private, dhe shkolla profesionale.

Megjithatë, edhe pse ka pasur përparime, ka ende sfida në sistemin arsimor, përfshirë nivelin e ulët të cilësisë së arsimit, Drejtoria e Arsimit po punon ngushtë me të gjithë akteret | duke përfshirë Qeverinë e Kosovës dhe Komunitetin Ndërkombëtarë | për të adresuar këto sfida dhe për të përmirësuar sistemin arsimor në tërësi.



*foto : shkolla filllore " Selami Hallaqi" Gjilan*

## Institucionet Parashkollore

1. Institucioni Parashkollor "Ardhmëria I" Gjilan
2. Institucioni Parashkollor "Ardhmëria II" Gjilan
3. Institucioni Parashkollor "Dardania" Gjilan
4. Institucioni Parashkollor "Integj" Gjilan
5. Institucioni Parashkollor në fshatin Zhegër

## Objektet shkollore ne Qytet | Shkolla fillore e mesme e ulët

1. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Thimi Mitko“ Gjilan
2. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Selami Hallqi“ Gjilan
3. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Rexhep Elmazi“ Gjilan
4. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Musa Zajmi“ Gjilan
5. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Abaz Ajeti“ Gjilan
6. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Nazmi Hoxha“ Gjilan
7. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Sadullah Brestovci“ Gjilan
8. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Zija Shemsiu“ Gjilan

## Objektet shkollore në fshatra | Shkolla fillore e mesme e ulët

9. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Liria“ Pogragjë
  - a) paralelja e ndarë ne fshatin Bilinicë
  - b) paralelja e ndarë ne fshatin Llovcë
10. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Vebi Ibrahimimi“ Uglar
11. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Avdullah Tahiri“ Malishevë
12. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Dëshmoret e Kombit“ Livoq i Ulët
13. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Vatra e Diturisë“ Mihirë
  - b) paralelja e ndarë ne fshatin Ponesh
14. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Ramiz Cërrnica“ Cërrnicë
  - a) paralelja e ndarë ne fshatin Gumnishtë
  - b) paralelja e ndarë ne fshatin Kravaricë
15. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Bajram Curri“ Shurdhan
16. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Agim Ramadani“ Zhegër
  - a) paralelja e ndarë ne fshatin Lladovë
  - b) paralelja e ndarë ne fshatin Nasalë

- c) paralelja e ndarë ne fshatin Haxhaj
- d) paralelja e ndarë ne fshatin Selishtë
- 17. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Nazim Hikmet“ Dobërçan
  - a) paralelja e ndarë ne fshatin Bukovik
- 18. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Skënderbeu“ Përlepticë
  - a) paralelja e ndarë ne fshatin Verbica e Kmetovcit
- 19. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Mulla Idrizi“ Velekincë
- 20. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Esat Berisha“ Llashticë
- 21. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Ibrahim Urqi“ Bresalcë
- 22. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Afërdita“ Kishnapolë
  - a) paralelja e ndarë ne fshatin Sllakoc
  - b) paralelja e ndarë ne fshatin Gadish
- 23. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Vesël Muji“ Mibirë
- 24. Shkolla e fillore e mesme e ultë „Fetah Qerimi“ Verbicë e Zhegovcit
  - b) paralelja e ndarë ne fshatin Zhegovcë

Objektet shkollore | Shkolla e mesme e lartë

1. Shkolla e mesme e lartë Gjinnazi Shoqëror „Zenel Hajdini“ Gjilan
2. Shkolla e mesme e lartë Gjinnazi Natyror „Xhavit Ahmeti“ Gjilan
3. Shkolla e mesme e lartë Teknika “Mehmeti Isai” Gjilan
4. Shkolla e mesme e lartë Mjekësia “Asllan Elezi” Gjilan
5. Shkolla e mesme e lartë Ekonomia “Marin Barleti” Gjilan
6. Shkolla e mesme e lartë Bujqësia “Arbëria” Gjilan
7. Shkolla e mesme e lartë e Arteve Pamore “Adem Kastrati” Gjilan
8. Shkolla e Muzikës

**Viti shkollor 2022/2023**

Numri i nxënësve femra : 7,838

---

Numri i nxënësve meshkuj : 7,816

---

Numri i përgjithshëm i nxënësve : 15,654

---

Numri i mësimdhënësve : 1,345

Sektori Privat : Institucionet Parashkollore dhe Objektet Shkollore si dhe numri i nxënësve | Komuna e Gjilanit

Institucionet Parashkollore "Nushe-T" Gjilan : 59

---

Institucionet Parashkollore "Thesari" Gjilan : 7

---

Institucionet Parashkollore "Bota" Gjilan : 46

---

Institucionet Parashkollore "Poema A" Gjilan : 40

---

Institucionet Parashkollore "Mësonjëtorja Qiriazhi" Gjilan : 41

---

Shkolla e fillore e Ulët dhe e Lartë "Don Bosko" Gjilan : 399

---

Shkolla e fillore e Ulët dhe e Lartë "Hello Academy of Education" Gjilan : 435

---

Total numri i nxënësve : 1027

### **Viti shkollor 2023/2024 | duke i përfshirë edhe shkollat private**

Numri i nxënësve shkolla fillore e mesme e ulët : 11,168

---

Numri i mësimdhënësve : 1,215

---

Numri i nxënësve shkolla fillore e mesme e lartë : 3,655

---

Numri i mësimdhënësve : 403

### **Komuniteti Serb | sektori i Arsimit**

Në komunën e Gjilanit, ka disa shkolla fillore dhe të mesme të komunitetit serb, këto shkolla ofrojnë arsim në gjuhën serbe:

Shkolla e fillore e Ulët dhe e Lartë „Vuk Karagjiq“ Shillovë & Kmetoc

---

Shkolla e fillore e Ulët dhe e Lartë "Dositej Obradović" Cërrnicë

---

Shkolla e fillore e Ulët dhe e Lartë "Sveti Sava" Posh

Numri i nxënësve :

- Institucionet parashkollore : 59

---

- Shkollat e fillore (I-VIII) : 267

---

- Shkollat e mesme (I-IV) : 251

---

- **Total numri i nxënësve : 577**

Këto shkolla ofrojnë programe të ndryshme shkencore dhe humane në gjuhën serbe dhe ka një histori të gjatë të shërbimit arsimor në Komunën e Gjilanit

### **Komuniteti Rom | sektori i Arsimit**

Komuna e Gjilanit ka krijuar kushte për të gjitha komuniteti sa i përket sektorit të arsimit, kjo do të ketë ndikim pozitive nga se kjo ndihmojë në zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë.

#### **Te dhënat e komuniteti Rom | numri i nxënësve dhe profilet**

Shkolla e fillore e mesme e ultë „Vuk Karagjiq“ Gjilan

Numri i nxënësve parashkollor : 19 (8 meshkuj | 11 femra)

---

Numri i nxënësve të shkollës fillore : 62 (31 meshkuj | 31 femra)

---

Numri i nxënësve të shkollës së mesme : 12 (3 meshkuj | 9 femra)

---

#### **Shkolla e mesme e lartë në fshatrat : Shillovë, Kufcë dhe Koretisht**

Numri i nxënësve të shkollës mesme Gjimnazi në fshatin Shillovë : 1

---

Numri i nxënësve të shkollës mesme e Mjekësisë në fshatin Shillovë : 1

---

Numri i nxënësve të shkollës mesme Teknike në fshatin Kufcë : 3

---

Numri i nxënësve të shkollës mesme Ekonomike në fshatin Koretishtë : 7

---

Numri i studenteve nga Komuniteti Rom : 3

---

### Shkollat fillore dhe mesme 2023/2024 | numri i nxënësve | Komuna e Gjilanit

Përshkrimi	Meshkuj	Femra	Total
Institucionet Parashkollore	371	367	738
Parashkollor (mosha 5 vjet)	502	487	989
Klasa I-V	3069	3051	6120
Klasa VI-IX	2424	2291	4715
Klasa X-XII	1852	1921	3773
<b>Total</b>	<b>8218</b>	<b>8117</b>	<b>16335</b>

skema :




foto : skema e numrit te nxënësve

## Universiteti

Në Regjionin Lindje | Gjilan | funksionon Universiteti Publik “Kadri Zeka” i cili ofron këto programe:

Bachelor :

- Fakulteti i Edukimit

---

- Fakulteti Juridik

---

- Fakulteti Ekonomik

---

- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike

---

- Fakulteti i Shkencave Aplikative

Master :

- Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike

---

- Master – E-Qeverisja

Regjioni Lindje | Gjilan | ka edhe Kolegjin UBT i cili për disa vite ka ofruar këto programe të studimit : Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi dhe Infermieri

Vitet e studimit 2024/2025 presim të filloj me programet e studimit të fakultetit apo të Shkollës e Mesme të Mjekësisë me dy drejtime : Bashkëpunëtor Profesional i Infermieri dhe Teknik i Laboratorit Mjekësor

## Gjendja sociale ne Arsim

Gjendja sociale në arsim në komunën e Gjilanit, është e ndikuar nga një sërë faktorësh të ndryshëm, përfshirë sfidat ekonomike, politike dhe shoqërore që ka përjetuar vendi.

*Disa nga këto sfida përfshijnë:*

1. **Emigracioni dhe pasojat sociale** : emigracioni ka qenë një realitet i përjetshëm në komunën e Gjilanit.
2. **Diskriminimi dhe pabarazia sociale** : kjo i mbetet të kaluarës, sot Komuna e Gjilanit siguron barazi dhe pjesëmarrje të barabartë në arsim për të gjithë nxënësit pa dallim etnie e gjinore



Konvikti i nxënësve dhe studentëve është një nga institucionet që ofrojnë strehim për nxënës dhe studentë, kapaciteti i këtij konvikti momentalisht është 132 shtretër / me mundësi zgjerimi sipas nevojës.

Efiçienca e Energjisë : Fondit të Kosovës për Efiçiençë të Energjisë | Komuna e Gjilanit, Ministrinë e Ekonomisë dhe KFW (Banka Gjermane), po punohet në zbatimin e masave të EE në objektet publike :

- SH.M.T “Mehmet Isai” Gjilan

---

- SH.F.M.U “Rexhep Elmazi” Gjilan

---

- SH.F.M.U “Abaz Ajeti” Gjilan

---

- SH.F.M.U “Liria” Pogragjë

---

- SH.F.M.U “Ibrahim Uruqi” Bresalc

---

- Objektet e Banimit Social

Gjatë këtij viti : Rreth 100 mësimdhënës kanë filluar trajnimin me temën “Menaxhimi i klasës dhe disiplina” në bashkëpunim me Qendrën për Edukim “Konica”. Një hap tutje, drejt planifikimit që rreth 500 mësimdhënës të marrin trajnime të ndryshme. Eje në drejtim të ngritjes së cilësisë në arsim.

## Infrastruktura

Infrastruktura në komunën e Gjilanit përfshin një gamë të gjerë të aspekteve të jetës së përditshme, të gjitha këto janë thelbësore për funksionimin e qytetit duke përfshirë:

- rrugët,

---

- sistemet e ujësjellës dhe kanalizimeve,

---

- energjinë dhe ndriçimin publik,

---

- menaxhimin e mbeturinave,

---

- transportin ndër urban dhe urban

---

- telekomunikimi dhe

---

- mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike

**Rrugët dhe trotuaret :** Komuna e Gjilanit ka një rrjet rrugor të zhvilluar, përfshirë rrugë kryesore që lidhin qytetin me qytete të tjera të Kosovës. Për të përmirësuar qasjen në rrugë dhe për të rritur sigurinë rrugore, vazhdimisht janë duke u bërë investime në ndërtimin dhe përmirësimin e rrugëve.

Është duke u punuar ne vazhdimësi për te përmirësuar gjendjen e rrugëve, tani me nuk ka asnjë lagje duke përfshirë qytetin dhe fshatrat qe nuk është përfshirë ne asfaltimin e rrugëve/ me gjithat ende po investohet dhe punohet ne këtë drejtim

Komuna e Gjilanit po hynë në fazë të re të zhvillimit : jemi drejt përfundimit te projekti i asfaltimit te rrugëve ne gjatësi : 7,356m te Livadhet e Arapit – Gjilan dhe asfaltimi i trotuarit, në fshatin Llashticë, në gjatësi prej 2261m.

Janë nënshkruam Memorandume te Bashkëfinancimit me Qeverinë e Kosovës në realizmi i këtyre projekteve :

- Ndërtimi i projektit të integruar të Bulevardit të qytetit | ndryshimi më i madh urbanistik ne historinë e qytetit : 30 mijë m2, 500 parkingje, duke e përfshirë edhe nënkalimin, 8,000 m2 objekti i komunës se re.
- Investimet në qarkoren | rruga Qarkore Ekzistuese
- Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Ranatoc – Kokaj dhe
- Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Nekibe Kelmendi” Gjilan
- Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Fidanishte 2” Gjilan
- Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Hamdi Kurteshi” te FSK - Gjilan
- Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve lidhëse në Livoq dhe Cernicë
- Ndërtimi i trotuarit në fshatin Bresalc.

**Sistemet e ujësjellës dhe kanalizimeve:** është thelbësore për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetareve, me sistemin e kanalizimit të ujerave fekale është i mbuluar i gjithë territori i komunës së Gjilanit në përjashtim viset e thella malore, me menaxhimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit menaxhon Ndërmarrja Publike “Hidromorava” vlen të ceket se për momentin nuk ka fabrikë të trajtimit të ujerave të zeza, edhe pse kemi fizibilitetin për këtë projekt madhor, po ashtu vlen të ceket se po punohet me Qeverinë e Kosovës dhe Komunitetin ndërkombëtar që ky projekti të realizohet.

Burimet e ujit : Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit është mbi 140 km, me dimensione 50- 400, jo vetëm qyteti por edhe të gjitha fshatrat e mëdha janë të këqyra në rrjetin e ujësjellësit.

Kapaciteti maksimal i prodhimit është 420 l/s, Komuna e Gjilanit furnizohet me ujë të pijshme nga këto burime : penda në fshatin Përlepnice ku ekziston edhe fabrika e përpunimit të ujit, lokacioni Guri i Hoxhës, lokacioni Baja dhe Velekica ku ekziston edhe fabrika e përpunimit të ujit.

Po ashtu vlen të ceket se ekziston edhe rrjeti i ujësjellësit industriale ku dikur me ujë furnizohej fabrika e Tekstilit, Baterive, Çeliku, Radiatorët etj. po ashtu ekziston edhe Penda e Livoqit e cila momentalisht shfrytëzohet për rekreacion .



Është duke u punuar sistemi i ujësjellësit për fshatin Uglar, është duke u punuar në Verbica e Kmetocit, në fshatin Vrapqiçi, Pogragjë, Bresalci.

Për fshatin Cërrnica është nënshkruar memorandumin e bashkëfinancimit me KRU “Hidromorava”, Ministria e Ekonomisë dhe Komuna e Gjilanit me vlerë 753,000 €, me gjatësi 18,840.48 m | kështu ditë për ditë, fshat për fshat, për sisteme ujësjellësi deri në fshatin e fundit.

**Energjia dhe ndriçimi publik:** furnizimin me energji dhe ndriçim publik janë thelbësore për funksionimin e qytetit. Investimet në këtë fushë përfshijnë modernizimin e infrastrukturës së energjisë dhe instalimin e sistemeve të ndriçimit publik të efektshëm dhe të qëndrueshëm.

Në komunën e Gjilanit ekzistojnë 4 TS 35/10 kv : Gjilani I deri Gilani IV dhe Lladova, 24 km lidhje kobllovice dhe 347 km lidhje ajrore me gjithsejtë 3476 shtylla elektrike dhe 271 trafo stacione 10/0.4 kv, me gjithsejtë 57 MVA fuqi instaluese 35/10(Kv) dhe 51.5 MVA fuqi instaluese Ts 110/35 (KV).

Trafo stacioni i ri “Gjilani V” donacion i ardhur nga Qeveria e Zvicrës përfundimisht Gjilani i ka thanë : lamtumirë territ dhe ngarkesave në trafo stacione në sezonin dimëror.

Ndriçimi publik tashmë nuk është luks, por është domosdoshmëri. Në qytet pothuajse të gjitha lagjet lagjeve kanë ndriçim publik, po ashtu edhe në fshatra tashmë ndriçimi është funksionalizuar në shumicën e fshatrave.

**Menaxhimi i mbeturinave :** Deponia Regjionale ndodhet në fshatin Velekicë (5km), menaxhimin e mbeturinave e menaxhon Ndërmarrja publiko-private “Ecohigjeina” ku si aktivitet primare ka grumbullimi, bartjen dhe deponimin e mbeturinave në komunat ku vepron | komuna e Gjilanit ka Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023 – 2027 i cili është në përputhje me Ministrin e linjës.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përmes një ceremonie ka nënshkruar marrëveshjen në vlerë mbi 12 milionë euro me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK), për çka synohet përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave në Prishtinë, Prizren dhe Gjilan.

Gjate muajit tetor 2024 | Qeveria e Kosovës - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, ka nënshkruar marrëveshjen në vlerë mbi 12 milionë euro me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK), pjesë e kësaj marrëveshje është Komuna e Gjilanit (si dhe Prishtina e Prizreni)

Kjo marrëveshja synon përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve duke garantuar një mjedisi më të pastër | projekti ka për qëllim të kontribuojë në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit .

**Transporti urban dhe ndërurban:** Komuna e Gjilanit ofron shërbime të transportit publik për banorët, duke përfshirë autobusë të rregullt që lidhin qytetin me fshatra të ndryshëm në rrethin e tij, si dhe me qytete të tjera në Kosovë. Këto shërbime janë thelbësore për të lehtësuar lëvizjen e banorëve nëpër qytet dhe përreth tij.

Linjat e autobusëve të transportit urban në komunën e Gjilanit mund të ndryshojnë në varësi të nevojave të komunitetit dhe zhvillimeve të infrastrukturës.

Komuna e Gjilanit ka Planin e Mobiliteti sa i përket transportit urban që ka për qëllim përmirësimin e shërbimeve | me gjithat nuk është funksionalizuar deri me tani.

Megjithatë kemi në dispozicion linja të ndryshme që shërbejnë për të lidhur pjesët e ndryshme të qytetit dhe fshatrave përreth.

Sa i përket transportit urban, sot kemi 14 operator privat që ushtrojnë transport të udhëtareve nga Gjilani në drejtim të secilit fshat : Gjilan - Llashticë - Gjilan, pastaj Gjilan Zhegër – Gjilan, Gjilan – Malishevë – Uglar – Pogagjë, Gjilan - Përlepnice e kështu me radhe.

Performanca për vitin 2023 transporti urban :

42 - numri i vendbanimeve / fshatrave

---

30 - numri i vendbanimeve të përfshira në vijat e transportit

---

76 – numri i vendndalesave për udhëtar

Po japim të dhënat sa i përket transportit urban, Ndërmarrja Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve”, ndërtimi i ri i objektit të stacionit të autobusëve në Gjilan do të ketë rol vendimtar në përmirësimin e sistemit të përgjithshëm të transportit duke i mundur lëvizje në destinacione të ndryshme, kjo është thelbësore veçanërisht për ata qytetare preferojnë të përdorin transportin publik lokal e ndër komunal.

Zbatimi i këtij projekti ambicioz është një sfidë e madhe për buxhetin e vogël të komunës sonë, kjo kërkon mbështetje financiare nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës pa të cilën nuk kemi mundësin as ta fillojmë e as ta realizojmë.



Realizimin me sukses të këtij projekti i cili do ti hapë rrugë krijimi i linjave te reja urbane, ndër urbanë dhe ndërkombëtare të transportit si dhe zgjerimin dhe krijimi i hapësirave të reja të punës dhe zgjerimin e kapaciteteve te infrastrukturës.

Linjat rajonale të autobusëve lidhin këtë qytet me qytete dhe zona të tjera në nivelin rajonal, këto linja ofrojnë shërbim transporti për banorët e Gjilanit për të udhëtuar në destinacione të ndryshme në rajonin e tyre, disa prej linjave rajonale të autobusëve që mund të operojnë në Gjilan janë:

Linja Gjilan - Prishtinë: kjo linjë lidh Gjilanin me kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën. Ajo ofron një shërbim të rregullt autobusi për të udhëtarëve që duan të udhëtojnë mes këtyre dy qyteteve.

Linja Gjilan - Ferizaj: Linja e autobusëve që lidh Gjilanin me qytetin tjetër të rëndësishëm në Kosovë, Ferizajn.

Linja Gjilan - Prizren: Linja që shërben për të lidhur Gjilanin me disa qytete dhe fshatra deri në Prizren.

Linja Gjilan - Kamenicë, | Linja Gjilan – Preshevë, Linja Gjilan – Bujanovc që siguron lidhjen mes Gjilanit dhe disa qyteteve dhe fshatrave në rajonin e Kamenicës dhe komunave te Kosovës Lindore.

Linja Gjilan – Likovë – Kumanovë : që lidh Gjilanin me disa qytete dhe fshatra në rajonin e Maqedonisë së Veriut / po ashtu kemi edhe linja për Shqipëri.

**Telekomunikimi :** Posta dhe Telekom i Kosovës (PTK) si operatori kryesor ofron një gamë të gjerë të shërbimeve, duke përfshirë: Shërbimet postare, duke përfshirë postën standarde, postën ekspres dhe postën për bizneset.

Pastaj një gamë e gjerë e shërbimeve telekomunikacioni, duke përfshirë telefonin fikse dhe mobile, internetin e brendshëm dhe ndërkombëtar, si dhe shërbime të tjera të telekomunikacionit.

Përveç Postës dhe Telekomit të Kosovës, në Gjilan vepron edhe operatori tjetër i rëndësishëm i telekomunikacionit dhe internetit, IPKO. IPKO ofron një gamë të gjerë të shërbimeve të telekomunikacionit dhe internetit, duke përfshirë telefonin mobile, internetin fiberoptik dhe kabllorë, shërbime televizive dhe shërbime të tjera të internetit.

Pos IPKOs dhe PTK sot funksionojnë edhe Kujtesa, ArtMotion, .... që ofrojnë shërbime televizive dhe shërbime të tjera të internetit

### **Mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike :**

Ndërmarrja Publike Lokale “ Tregu” Sh.A Gjilan është përgjegjëse për **mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike** | Ndërmarrja “Tregu” deri në fund të muajit Nëntor 2023 numëron rreth 285 punëtorë të cilët janë të angazhuar edhe në mirëmbajtje tjera.

Ndërmarrja Publike Lokale “ Tregu” Sh.A Gjilan menaxhon dhe mirëmban edhe :

---

Hapësirat e Tregut të Gjelbër – Gjilan

---

Hapësirat e Tregut të Kafshëve në fshatin Velekincë

---

Hapësirat Tregut të Gjelbër në fshatin Zhegër



*foto : parku "Baja" Gjilan*

Viti 2023/2024 | është duke u punuar ne krijimin e hapësirave te reja "Xhepat e gjelbër" po e cekim disa : parkut Banja, parku Urban pjesa te posta e vogël, parku në fshatin Mires, parku në fshatin Demiraj, e se shpejti do përfundojnë punimet ne lagjen Iliria, në jetësim e sipër është edhe ai në lagjen Iliria, ndërsa punimet kanë filluar edhe në fshatin Shillovë.

### **Sipërfaqet e parqeve dhe hapësirave publike | Mirëmbajtja**

---

sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike ne hektar : 12 ha

---

sipërfaqja e hapësirave publike komunale ne hektar : 161.04 ha

---

sipërfaqja e hapësirave publike qe mirëmbahen rregullisht : 9,36 ha

---

numri i përgjithshme i hapësirave publike : 52

---

numri i hapësirave publike t pajisura me ndriçim publik eshë : 39

Gjatë këtyre dy vite ne Komunën e Gjilanit është punuar ne realizmin e projekteve të pastrimit të shtratit të lumenjve ishte një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit të mjedisit



dhe infrastrukturës së ujit. Komuna ka përgjegjësi për të siguruar që lumenjtë të mbahen të pastër dhe të shëndetshëm për mjedisin dhe komunitetin lokal, prandaj edhe është punuar ne këtë drejtim.



*foto : pastrimit të shtratit të lumenjve - Gjilan*

## Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale

Në përgjithësi, sistemi shëndetësor dhe mirëqenia sociale në Gjilan kanë qenë në një proces të përmirësimit të vazhdueshëm. Komuna por edhe Qeveria ka bërë përpjekje për të rritur aksesin në kujdes shëndetësor dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve shëndetësore.

Numri i objekteve shëndetësore në Komunën e Gjilanit

- 1 - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)
- 12 - Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF)
- 9 – Ambulanta në Mjekësinë Familjare (AMF)

Në Komunën e Gjilanit, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) është institucioni qendror që ofron shërbime shëndetësore bazike për komunitetin lokal.

Këtu, pacientët mund të regjistrohen për kontrollin e rregullt mjekësor, të marrin këshilla për shëndetin, të bëjnë teste bazike shëndetësore dhe të trajtohen për sëmundje të ndryshme.

Qendrat e mjekësisë familjare janë shpesh pikat e parë të kontaktit për pacientët kur ata kanë nevojë për kujdes shëndetësor dhe shpesh përcaktojnë nëse pacientët duhet të drejtohen tek specialiste të tjerë për trajtim të mëtejshëm.

Të punësuar 244 punëtorë (mjek dhe infermier) si dhe 61 ordianca private, po ashtu kemi :

Qendrën për Shëndetin Mendor

Shtëpia për Integrim në Bashkësi

Qendrën për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës si dhe

Qendrën e Punëve Sociale

Qendrën e Kujdesit Ditor për Personat e Moshuar (ne proces)

Gjate vitit 2023 Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulanta në Mjekësinë Familjare (AMF) kanë kryer këto vizita dhe shërbimeve 263,205 – shërbime | mosha 0 – 65+, 804 – shërbime mamografi, 13,765 – shërbime stomatologjike, 7918 – shërbime tjera (certifikata dhe dokumente te tjera)

### Të dhëna tjera :

- ✓ Numri i anëtarëve të familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale në Komunën e Gjilanit janë **527** familje me **1902** anëtarë.
- ✓ Numri i përfituesve të skemës të pensioneve për veteranët e luftës : 1929
- ✓ Numri i anëtarëve të familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e pensioneve për familjet dhe fëmijët e dëshmorëve dhe invalidët : 24 familje,
  - 56 fëmijë dhe
  - 48 invalidë.
- ✓ Numri i përfituesve të pensionit bazike të moshës : 9 583
- ✓ Numri i përfituesve të pensionet kontribut paguese të moshës : 2112
- ✓ Numri i përfituesve të pensionit për personave me aftësi të kufizuara : 1343

Në vazhdimësi Drejtoria po punon në hapjen rruge te kuadrove te reja, tani kanë filluar punën në sistemin primar shëndetësor, e gjitha angazhimi e qëllimi jonë i përbashkët është shërbimi cilësor për pacientët, tani 6 mjekë, 10 infermierë, 2 stomatologë dhe 1 teknik i stomatologjisë janë bashkuar mjekësisë familjare.

Ne vazhdimësi po punohet dhe po synohet për një kujdes shëndetësor të qëndrueshëm duke modernizuar dhe marr hapa kyç si : Digjitalizimi e sistemin për konsultime online, pastaj, dosjet elektronike të pacientëve, Rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të promovimit të edukimit, Integrimin e shërbimeve: ku përfshihen specialistë të parandalimit të sëmundjeve, duke përfshirë fushën e vaksinimit, shëndetit mendor, stomatologë dhe shërbime sociale si dhe po punohet Bashkëpunimi ndërkombëtar me organizata ndërkombëtare për shkëmbim të përvojave dhe praktikave më të mira në fushën e shëndetit primar.

Spitali Regjional i Gjilanit ka 522 punëtorë prej tyre 109 mjekë specialiste, 319 infermier, 94 staf mbështetës: ekonomiste, bio-inxhinier, jurist dhe punëtorë tjerë ndihmës .

Spitali Regjional i Gjilanit funksionon ne kuadër te Ministrisë se Shëndetësisë dhe ofron shërbime shëndetësore për nivelin dytësor për popullatën e regjionit te Gjilanit.

Spitali Regjional i Gjilanit ka kapacitet prej 450 shtretërve, 17 reparte : gjinekologjia, interno, dializa, pediatria, kirurgjia, anesteziologjia, ortopedia, urologjia, infektivë, sëmundjet e mushkërive, ndihma e shpejtë - emergjenca, ORL, oftalmologjia, laborator, transfuzioni i gjakut, materniteti etj.

## **Ekonomia Lokale – Zhvillimi Ekonomik**

Gjilani duhet të njihet për vlerat që i ka | ka ardhur koha të mendojmë parimisht por edhe krijojmë strategji të qëndrueshme, sepse bazuar në Ligjin nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, komunat kanë kompetenca të plota në Zhvillimin Ekonomik Lokal.

**Dikur | Sektori shoqëror :** është përballur me shumë probleme për shkak të humbjeve të mëdha gjatë periudhës së okupimit (në dekadën e fundit të shekullit XX), por gjithashtu edhe për shkak të transformimit ekonomik pas luftës në Kosovë, pra pas vitit 1999.

Pengesat kryesore janë: mungesa e kapitalit qarkullues, sigurimi i lëndës së parë, mungesa e investimeve, humbja e tregjeve, etj.

Shpresa e vetme për sektorin shoqëror të ekonomisë ishte privatizimi i ndërmarrjeve, tani ky proces është në përfundim e sipër dhe po menaxhohet nga Agjencia Kosovare i Privatizimit, <http://www.pak-ks.org>

**Sot | Sektori privat :** në Gjilan daton kryesisht nga fundi i viteve të tetëdhjeta (1989), duke u zhvilluar intensivisht pas përfundimit të luftës nga qershori i vitit 1999.

Gjate vitit 2010, Hapet Qendra Komunale për Regjistrim të Bizneseve (QKRB) në Gjilan, që ka lehtësuar afaristët e këtushëm | më nuk kanë më nevojë të shkojnë në Prishtinë | Decentralizimi i kompetencës për Regjistrim të Bizneseve ka pas reflektim shumë pozitiv të komuniteti i biznesit.

Sipas raportit të Qendra Komunale për Regjistrim të Bizneseve (QKRB) në Gjilan për vitin 2023 kemi këto të dhëna :

- ✓ 72 – numri i bizneseve prodhuese të regjistruara

---

- ✓ 124 - numri i bizneseve tregtare të regjistruara

---

- ✓ 385 - numri i bizneseve shërbyese të regjistruara

---

- ✓ 32 - numri i bizneseve ndërtimore të regjistruara

---

- ✓ 613 - numri i bizneseve të regjistruara

---

- ✓ 124 – numri i bizneseve të shuara

---

- ✓ 1073 – punëtorëve që kanë deklaruar gjatë regjistrimit

Sot, ekzistojnë mbi **3200** ndërmarrje që janë të regjistruara, më shumë se 75% e ndërmarrjeve private të regjistruara janë të angazhuara në Aktivitete Tregtare e Shërbyese, duke punësuar më shumë se 63% të numrit total të punësuarve në sektorin privat.

Vetëm 10.5% e ndërmarrjeve janë të angazhuara në krijimin e vlerës së re – në prodhim, dhe kemi trend në rritje | rritje kemi edhe në Sektorin e Ndërtimitarisë | për dallim nga viti paraprak | në sektorin e Ndërtimitarisë kemi rritje të bizneseve aktive për 8%

Zhvillimi i sektorit privat është promovuar si një motor kryesor i rritjes ekonomike, ka pasur ngritje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në sektorë të ndryshëm, duke kontribuar në krijimin e vendeve të punës dhe në rritjen e prodhimit lokal.

Ekonomia lokale e Gjilanit përfshin një gamë të gjerë sektorësh dhe aktivitetesth ekonomike. Disa prej sektorëve kryesorë në ekonominë e Gjilanit përfshijnë:

1. **Industria e ushqimit** : Gjilani ka një sektor të zhvilluar të prodhimit të ushqimeve, duke përfshirë prodhimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore.
2. **Industria e prodhimit të radiatorëve** : njohur si Jugoterm, fabrika e radiatorëve “Enrad” ka afro 40 vite përvojë dhe është një nga prodhuesit kryesorë të radiatorëve panel dhe gypor në Kosovë dhe në rajon.
3. **Tregtia dhe shërbimet**: Gjilani ka një aktivitet të zhvilluar tregtar dhe sektor shërbimesh, duke përfshirë biznese të ndryshme si restorante, hotele, dhe shërbime të tjera të konsumit.
4. **Industria e ndërtimit**: Ndërtimi është një sektor që ka rritur rëndësinë në vitet e fundit, me zhvillime të reja të objekteve të banimit dhe infrastrukturës.

## TË DHËNA TJERA

- ✓ *Studimi i fizibilitetit për Zonën Ekonomike – Livoq* | sipërfaqja e ndarë e Zonës Ekonomike prej 146.5 hektarë është lehtësisht e arritshme nga se aseti kryesor | Toka | është në pronësi komunale dhe komuna e Gjilanit si pronare do ta ketë më të lehtë zhvillimin e kësaj zone ekonomike, pa kosto për shpronësim, kjo e bene edhe me atraktive.
- ✓ *Dhënia e tokës në shfrytëzim afatgjatë | 99 vite* | Komuna e Gjilanit i ka dhënë në shfrytëzim për 99 vjet kompanisë “Albimi LTD” | Fabrika e kompanisë “Albimi LTD pritet të ndërtohet në këtë zonë, ku do të bëhet dizajnimi, montimi i biçikletave.
- ✓ *Studimi i fizibiliteti për Ndërtimin e Inkubatorit te Biznesit* | i cili ka shumë rëndësi për zhvillimin ekonomik dhe përkrahjen e ndërmarrësisë në nivel lokal.

### **Karakteristikat :**

- ⊙ Zona Kadastrale : Livoç i Epërm
- ⊙ Njësia : P-70403016-00708-4
- ⊙ Sipërfaqja: 15000m<sup>2</sup>
- ⊙ Klasi – 5 (pesë)

## Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës | Njësia në Gjilan

**Tregu i Punës** - Papunësia komunën e Gjilanit, si në shumicën e rajoneve të Kosovës, është një çështje e rëndësishme dhe komplekse!

Komuna e Gjilanit - Të dhënat e pranuar nga Qendra Rajonale e Punësimit :

- 1094 - sipas sistemit janë aktiv
- 6146 - sipas sistemit janë pasivë
- **7241 - Totali**

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik bashkëpunon ngushtë me **Qendrën për Aftësim Profesional (QAP Gjilan)** është institucion në kuadër të Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës dhe i Akredituar nga Autoriteti i Kualifikimeve.

Qendrën për Aftësim Profesional (QAP Gjilan) këtë vit janë Akredituar nga Autoriteti i Kualifikimeve këto profesione :

- metal punës
- saldim dhe
- zdrukthëtar

Qendra të Aftësimit Profesional Gjilan ofron : Trajnimi institucional në Qendrat e Aftësimit Profesional dhe Trajnimi i kombinuar (QAP dhe Kompani/ sektori privat).

Kohëzgjatja e trajnimit është 3-6 muaj, kandidati i nënshtrohet testit pas çdo moduli që zhvillohet si dhe testin përfundimtarë dhe pas trajnimit merr certifikatë mbi kompetencat e marra dhe me rëndësishmja është se trajnimet janë 30% teori dhe 70% praktikë.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik i ka hapur rrugë secilit aktivitet që ndikon në rritjen dhe qëndrueshmërinë ekonomike, e gjitha me koordinim të plot me komunitetin e biznesit !

Komuna e Gjilanit / drejtoria për zhvillim ekonomik edhe gjate vitit 2024 ka ndare buxhet për fazën e dytë / Bizneset Start-up dhe Biznese në Pronësi të Grave Ndërmarrëse për mundësin e përfitimit të granteve nga “Fondi për Subvencionimin e Bizneseve Start-up dhe Bizneset e Grave Ndërmarrëse 2024” projekti fillon te realizohet nga muaji mars 2024 / sa pe njoftim kjo është e para here për këto 25 vite pas lufte qe komuna ndanë buxhet

për realizimin e këtyre projekteve të cilat e ndihmojnë zhvillimin e biznesit / i kemi hapur rruge ideve dhe iniciativave të reja .

Komuna e Gjilanit në bazë të planeve rregulluese dhe strategjisë zhvillimore ekonomike ka identifikuar zonën ekonomike e cila do të hap rrugë perspektives zhvillimore ekonomike, me gjithat ne mungese të mjeteve buxhetore nuk kemi arritur që të funksionalizohet.

Ambiciet e tona janë që të ndërtojmë parakushte të mira për ardhje të investimeve në komunën e Gjilanit dhe për zhvillim sa më të shpejtë ekonomik të saj.

Gjilani - Qender Rajonale | Gjilani është përzgjedhur si qendër rajonale për shkak të faktorëve të mëposhtëm:

1. **Pozita Gjeografike:** Pozicioni i tij strategjik në rajon e bën një qendër të përshtatshme dhe të qasueshme për qytetarët dhe autoritetet rajonale.
2. **Pozita Administrative:** Ka funksionuar si qendër administrative për një gamë të gjerë shërbimesh publike dhe private që shërbejnë rajonin përreth, duke përfshirë :
  - Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovë
  - Qendra për Aftësim Profesional
  - Administrata Tatimore e Kosovës
  - Agjencia e Statistikave të Kosovës
  - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës
  - Agjencioni për Zhvillim Rajonal (AZHR)
  - Agjencia e Pyjeve të Kosovës
  - Oda Ekonomike



## **Bujqësia dhe Zhvillimi Rural:**

Bujqësia dhe zhvillimi rural janë sektorë thelbësore për ekonominë lokale, sigurinë ushqimore dhe tërheqjen e investimeve në zonat rurale.

Sektori bujqësor është gjithashtu i rëndësishëm në ekonominë e Gjilanit, me prodhim të kulturave të ndryshme bujqësore dhe bimorë.

Gjilani ka një traditë bujqësore të theksuar, bujqësia është burimi kryesor i të ardhurave për shumë banorë të zonës rurale.

Mbështetja për fermerët nuk po mungon nëpërmjet teknologjisë së avancuar bujqësore, investime në pajisje dhe infrastrukturë bujqësore.

Nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës, e cila është 39 071 hektarë, 99,75% është mbulesë tokësore, ndërsa 0,25%, ose 96,5 hektarë është e mbuluar me ujë, 54,1% e tokës përbëhet nga pyje, ndërsa 45,99% është tokë bujqësore. Shumica e pyjeve (6,89%) përbëhen nga pemë halore, 93.11% nga pemë gjetherënëse.

Sipërfaqja e tokës bujqësore në shfrytëzim është 17 969 ha, ndërsa kopsht edhe sera kemi 46 ha.

Numri i ekonomive bujqësore është 4165 ferma, me grurë i kemi 2970 ha, misër 1043 ha, perime 121 ha. Me pemë frutore i kemi 294 ha, prej tyre mollë 126.80 ha, kumbull 74 ha, vishnje 46 ha, dardhë 13 ha, dredhëz 10 ha, dhe mjedër 13 ha.

Sa i përket blegtorisë, aktualisht janë të evidentuara 2700 krerë gjedhe, në 300 ekonomi bujqësore, 5200 dele në 80 ekonomi bujqësore si dhe 1500 krerë dhi në 60 ekonomi bujqësore. Gjithashtu në komunën e Gjilanit ka pula vojse rreth 26700 copë në tri ferma të mëdha dhe rreth 10.000 pula në ekonomitë familjare, bletë (koshere) 9000 në 230 ekonomi bujqësore, derra rreth 900 krerë. Po ashtu janë edhe 2 qumështore, 5 thertore, 4 ambulanca veterinare.

Mbrojtja dhe shfrytëzimi i natyrës është i rregulluar sipas Ligjit Nr. 03/L-233 për mbrojtjen e natyrës. Që nga themelimi i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKNP), shumë zona, monumente dhe vlera të tjera natyrore janë mbrojtur ligjërisht, duke përfshirë asetet e trashëgimisë natyrore. Në komunë Zona e mbrojtur në komunën e Gjilanit mbulon 3.18 hektarë

Komuna e Gjilanit çdo vit është duke rritur buxhetin e saj dedikuar për subvencione në bujqësi. Gjithashtu një kontribut të konsiderueshëm janë duke dhënë edhe organizatat e ndryshme jo qeveritare dhe qeveritare nga vendet e ndryshme. Po ashtu fermerët çdo vit përfitojnë nga grantet dhe subvencionet që ndanë Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural. Janë hapur dhe riparuar shumë rrugë bujqësore. Sot të gjithë fermerët kanë qasje në pronat e tyre me çfarëdo lloj mekanizmi (makine) bujqësor/e.

Bujqësia dhe zhvillimi rural : si objektivi tjetër është avancimi i teknologjisë përpunuese përmes mekanizimit bujqësor duke i subvencionuar fermerët për çdo vit me mekanizëm bujqësor. Subvencionimi i fermerëve me mekanizëm modern bujqësor, ndikon direkt në cilësinë e produkteve të cilat përdoren në industrinë agropërpunuese, e që i ndihmon fermerët t'i rrisin kapacitetet e tyre.

Bujqësia dhe zhvillimi rural : si objektivi tjetër është organizimi i trajnimeve dhe këshillimeve të fermerëve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të tyre profesionale, mbështetja me qëllim të avancimit të teknologjive të prodhimit, pastaj modernizimi i mekanizimit (makinave) bujqësor/e etj.

Zhvillimi i këtyre aspekteve do të ndikojë në inkurajimin e fermerëve për të rritur kapacitetet e tyre prodhuese, për të shtuar rendimentin dhe cilësinë e prodhimit, për të investuar në marketingun e produkteve bujqësore dhe të gjitha këto do të ndikojnë në intensifikim e zhvillimit të tyre.

Spektori bujqësor është gjithashtu i rëndësishëm në ekonominë e Gjilanit, me prodhim të kulturave të ndryshme bujqësore.

Gjilani ka një traditë bujqësore të theksuar. Afër 50 % e banorëve të komunës së Gjilanit jetojnë në vendbanimet rurale ku bujqësia është burimi kryesor i të ardhurave për shumicën e banorëve të këtyre zonave.

## Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore

Komuna e Gjilanit, është e pasur me trashëgimi kulturore dhe historike që e bën atë një destinacion tërheqës për turistët.

Për nga aspekti turistik komuna e Gjilanit mund të ndahet në këto lokalitete turistike: Malet e Zhegocit; Malet e Karadakut (ose Malet e Zeza) , Malet e Sllubicës, Lugu i Haxhajve të Zhegrës, Lugu i Bukovikut , Lugu i Burincës , Gryka e Llapushnicës, Shpella e Bresalcit, Shpella e Resulës, Lumi Morava e Binçës, Lumi Mirusha , Liqeni i Livoçit, Uji Mineral i Nasalës, Burimi i ujit në fshatin Pidiq , si dhe Banjat minerale: Banja e Uglarit , Banja e Mireshit, dhe Banja e Dunavit.

Muzeu Etnologjik i Gjilanit: Ky muze është një vend ku mund të studiohet historiku dhe kultura e Gjilanit dhe rajonit përreth | Trashëgimia kulturore në shërbim të zhvillimit të turizmit siç është Muzeu i Qytetit i cili ndryshe njihet si “Objekti i Kajmekamllakut” gjendet në qendër të qytetit | Shkolla e Muzikës, përballë Atik Xhamisë, ky objekt quhej Saraji i Mustafë Pashës;



Diversiteti fetar e kulturor | Komuna e Gjilanit karakterizohet me një diversitet i madh fetar dhe kulturor. Kosova si vend në përgjithësi është i njohur për këtë diversitet, pasi që përfshin një varg komunitetesh fetare dhe etnike të ndryshme.

Popullsia me shumicën u përkasin besimit mysliman, ka një pjesë të popullsisë që janë të krishterë dhe të tjerë.

Në përgjithësi, Gjilani është një shembull i mirë i harmonisë së komuniteteve fetare dhe kulturore në një mjedis urban.

Kalaja e Pogragjës, gjendet në kilometrin e 10 nga qyteti i Gjilanit, në fshatin Pogragjë, krahas kalasë është mjaft atraktive edhe Gryka e Llapushnicës; Fortifikata parahistorike në Cërnicë; Kalaja e Mireshit, është monument i trashëgimisë kulturore në Miresh, Dobërçan, Kalaja e Pidiqit, është monument i trashëgimisë kulturore në Pidiq-Shurdhan, Kalaja e Përlepticës, etj. Atik Xhamia, xhamia e Cernicës, xhamia e Dobërçanit, kisha katolike „Kisha e Shën Anës” në fshatin Dunavë, tyrbet në qytet, kisha e Shën Nikollës, Sahat Kulla.

Pastaj janë Atraksionet Natyrore: Penda e Livoçit, lokaliteti Stublinë, lokaliteti Zhegoc me rrethinë, lokaliteti Stanishor me rrethinë, liqeni i Përlepticës, dhe burimet termale në Uglar dhe Dobërçan.

Komuna e Gjilanit ka 41 xhami dhe 8 kisha ortodokse. (burimi: përfaqësues të bashkësive fetare). Gjithsej 64 objekte të trashëgimisë kulturore (27 arkeologjike dhe 37 arkitekturore) janë përfshirë në listën e vendeve nën mbrojtje të përhershme/përkohshme të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Muzeu Etnologjik i Gjilanit : Ky muze është një vend ku mund të studiohet historiku dhe kultura e Gjilanit dhe rajonit përreth .



*Harta: Disa nga objektet e trashëgimisë kulturore*

Në komunën e Gjilanit janë 244 ndërmarrje dhe punëtori hoteliere të cilat iu ofrojnë qytetarëve shërbime të fjetjes, ushqimit, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, ahengejeve familjare, banketeve, seminareve, trajnimeve dhe shërbimeve të tjera.

Kultura : Teatri i Qytetit të Gjilanit, Flaka e janarit është një festival kulturor multidimensional, i cili fillon më 11 janar Gjilan dhe me ndezjen simbolike të flakadanit, për të vazhduar deri më 31 janar me aktivitete të ndryshme kulturore.

Monumentet historike : Varrezat e Dëshmorëve është një vend i rëndësishëm historik dhe memorial i cili i kushtohet dëshmorëve të qytetit të Gjilanit që sakrifikuan jetën për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Komuna e Gjilanit ka 41 xhami dhe 8 kisha ortodokse. (burimi: përfaqësues të bashkësive fetare). Gjithsej 64 objekte të trashëgimisë kulturore (27 arkeologjike dhe 37 arkitekturore) janë përfshirë në listën e vendeve nën mbrojtje të përhershme/përkohshme të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit

## 5.2 Krahasimi me vendet/komunat të tjera

Krahasimi i Komunës së Gjilanit me komunat e tjera fqinje është | Komuna e Gjilanit, si njësi administrative në Kosovë, ka mundësi potenciale në krahasim me komunat e tjera, disa aspekte që mund të përfshihen në një krahasim:

1. **Lokacioni gjeografik:** Gjilani ndodhet në juglindje të Kosovës, afër kufirit me Maqedoninë e Veriut dhe Serbin. Ky lokacion mund të sjellë avantazhe strategjike në lidhje me tregtinë ndërkufitare dhe qasjen në tregjet e tjera rajonale | Kordiorët 8 dhe 10
2. **Bujqësia dhe resurset natyrore:** Gjilani ka një potencial bujqësor dhe resurse natyrore të rëndësishme për zhvillimin e sektorit bujqësor dhe të tjerëve, përfshirë bujqësinë, kulturën dhe të tjerëve
3. **Demografia dhe popullsia:** Numri i popullsisë së Gjilanit, struktura e popullsisë dhe rritja demografike mund të krahasohen me komunat e tjera. Diaspora e Gjilanit është një element kyç për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të komunitetit, duke sjellë kontribute të rëndësishme në disa fusha si :
  - **Kontributi ekonomik:** Diaspora e Gjilanit ka qenë një burim i rëndësishëm i investimeve dhe ndihmës financiare për komunitetin. Pjesa e madhe e këtyre kontributeve shkon për të mbështetur zhvillimin e infrastrukturës, shërbimeve shëndetësore, arsimin dhe të tjera.
  - **Investime dhe biznese:** Përvoja dhe kapacitetet e anëtarëve të diasporës janë shfrytëzuar për të hapur biznese dhe projekte të ndryshme në Gjilan, kjo ka krijuar mundësi të reja të punësimit dhe rritje ekonomike në rajon.
  - **Ndihma humanitare dhe shkëmbimet kulturore:** Diaspora e Gjilanit ka përkrahur komunitetin me ndihma humanitare në kohë krizash dhe emergjencash. Përveç kësaj, ajo ka kontribuar në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe historike të Gjilanit nëpërmjet aktiviteteve kulturore dhe shkëmbimeve.
  - **Lidhje të fortë shoqërore dhe kulturore:** Anëtarët e diasporës ruajnë lidhjet e tyre të fortë me Gjilanin, duke krijuar një rrjet të gjerë shoqëror dhe kulturor që përforcon identitetin dhe bashkësinë e komunitetit.

### 5.3 SWOT analiza

Përparësitë	Dobësitë
